



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 59, datë 30.06.2020

PËR  
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT  
TË BASHKISË DURRËS PËR PERIUDHËN KORRIK 2020 – DHJETOR 2020

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar , neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1 , gërma “b”, të nenit 51, pika 3, nenit 54 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar dhe në zbatim të Rregullores së Funkionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak, Kreu VIII. Financimi I Aktiviteteve Të Këshillit, Neni 101 “Programi i Punës së Këshillit Bashkiak” dhe sipas relacionit të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve, me propozim të Kryetarit të Këshillit,

KËSHILLI BASHKIAK  
V E N D O S I :

1. Miratimin e programit të punës së Këshillit të Bashkisë Durrës për periudhën Korrik 2020 – Dhjetor 2020, bashkëngjitur këtij vendimi .
2. Ngarkohet për zbatim të këtij vendimi Këshilli Bashkiak Durrës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).


KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 01.07.2020

**PROGRAMI PUNËS  
I KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS PËR PERIU DHËN  
KORRIK 2020 – DHJETOR 2020**

Muaji	Lista e çështjeve	Institucioni Nismëtar	Komisioni Përgjegjës që ngarkohet për shqyrtim
Korrik	 <p>1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Korrik 2020.</p> <p>2. Për miratimin e rregulloreve për marrëdhënjet e këshillit bashkiak me publikun dhe median</p> <p>3. Për miratimin e Rregullores Për Paraqitjen Dhe Shqyrtimin E Ankesave, Vërejtjeve, Kërkesave, Peticioneve Dhe Iniciativave Qytetare</p>	<p>Bashkia Durrës</p> <p>Komisioni i Rregulloreve, Çështjeve Juridike</p> <p>Komisioni i Rregulloreve, Çështjeve Juridike</p>	<p>Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale</p> <p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Këshilli Bashkiak</p>
Gusht	<p>1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë , për muajin Gusht 2020</p>	Bashkia Durrës	Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale
Shtator	<p>1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Shtator 2020.</p>	Bashkia Durrës	Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale
Tetor	<p>1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Tetor 2020</p>	Bashkia Durrës	Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale

	<p>2. Me kërkesë të Këshillit Bashkiak, Kryetari i Bashkisë raporton gjatë vitit edhe për çështje të tjera, që kanë lidhje me zbatimin e buxhetit dhe kontrollin e brendshëm financiar publik të Bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë (<i>Ligji nr. 68/2017, neni 48/6</i>)</p> <p>3. Me kërkesë të Këshillit Bashkiak, Kryetari i Bashkisë raporton për sezonin e turistik në Durrës</p>	<p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Këshilli Bashkiak</p>	<p>Kryetari Bashkisë</p> <p>Kryetari Bashkisë</p>
Nëntor	<p>1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë , për muajin Nëntor 2020</p> <p>2. Këshilli informohet dhe diskuton raportin e përmbledhur, për 4-mujorin e dytë, (8-Mujor), mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (<i>Ligji nr. 68/2017, neni 44/4</i>).</p> <p>3. Projekt planin vjetor të punës së Këshillit Bashkiak për vitin 2021.</p> <p>4. Këshilli merr nga Kryetari i Bashkisë projekt dokumentin përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm dhe të projekt-buxhetit vjetor (30 nëntor)</p>	<p>Bashkia Durrës</p> <p>Bashkia Durrës</p> <p>Konferenca e Kryetareve</p> <p>Bashkia Durrës</p>	<p>Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale</p> <p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike</p> <p>Këshilli Bashkiak</p>
Dhjetor	<p>1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Dhjetor 2020</p>	<p>Bashkia Durrës</p>	<p>Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale</p>

	<p>2. Këshilli bën publik në faqen e internetit të Bashkisë projekt dokumentin përfundimtar të PBA-së dhe të projekt-buxhetit vjetor të depozituar nga Kryetari i Bashkisë</p>	Këshilli Bashkiak	Sekretariati Këshillit
	<p>3. Për miratimin e buxhetit të bashkisë durrës për vitin 2021, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të bashkisë durrës për vitet 2021-2023 (25 dhjetor)</p>	Bashkia Durrës	Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave
	<p>4. Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (PBA) për vitet 2022-2024 dhe buxhetit vjetor</p>	Bashkia Durrës	Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave
	<p>5. Për miratimin e listës emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar dhe konvikteve të shkollave të mesme dhe profesionale, që plotësojnë kriteret për përfitimin e bursave dhe pagesave për vitin shkollor 2020-2021</p>	Bashkia Durrës	Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 586/prot.  
/3

Durrës, më 06.07.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.59 datë 30.06.2020 “Për miratimin e programit të punës së Këshillit të Bashkisë Durrës për periudhën Korrik 2020 – Dhjetor 2020”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

